



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2023:112573

Datë: 04.11.2024

Numri i dokumentit: 06396894

C.nr.1048/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Binak Duqi, dhe bashkëpunëtorin profesional Mensur Avdullahu në çështjen juridike kontestimore të paditëses M. L. me numër personal me vendbanim në P., të cilin e përfaqëson me autorizim Shoqëria e Avokatëve: Studio Ligjore & Financiare “K. A.”, me adresë Blv. “D. e K.”, U. C-... – P., kundër të paditurës Komuna e Podujevës-Drejtoria e Arsimit në P., me adresë në rr. “N. G.” P., e përfaqësuar nga F. R., me objekt kontesti: kompensim i pagave jubilarë, me vlerë të kontestit: **530.16 Euro**, jashtë seance, me dt. 02.11.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Refuzohet në tersi si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses M..e L. me të cilën ka kërkuar që të:

“I. Aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses M. L..

II. Detyrohet e paditura Komuna e Podujevës – Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) që paditësit t’i paguajë kompensimin e shpërblimit jubilar 100 % të pagës bazë shumë prej 530.16 euro, me kamatë ligjore prej 8 % nga dita e ushtrimit të padisë gjerë në pagesën definitive.

III. Detyrohet e paditura që paditësit t’ia kompensojë shpenzimet procedurale.

Prestimet nga pika e mësipërme të këtij dispozitivi, e paditura detyrohet që t’i përmbushë në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e marrjes së aktgjyqimit, nën kërcënim të përmbarrimit.”

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja M. L., përmes të autorizuarit të tij, me datën 19.05.2023, ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Podujevës-Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensim të pagave jubilarë.

E njëjta në padi ka theksuar se është në marrëdhënie të punës me të paditurën në cilësinë mesimdhënësit në Gjimnazin “A. Xh.” në P.. Tutje ka theksuar se përkundër obligimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit e datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021, e paditura nuk e ka bërë kompensimin e pagës jubilarë sipas viteve të përvojës së punës, i cili ka më shumë se 10 vite, dhe se i takon 50 % e pagës bazë në shumën prej 229.5 €. Tutje thekson se sipas kontratës kolektive sektoriale të arsimit të nënshkruar nga MASHT, përkatësisht dispozitave të nenit 35 par. 8, dhe Ligjit të Punës (nenet 4,10,11,55,90), e paditura është e obliguar që në bazë të fitimit të së drejtës, paditësit t’ia paguaj kompensimin e shpërblimit jubilar sipas viteve të përvojës së punës, andaj shton se me qëllim të realizimit të këtyre të drejtave, të nxirret aktgjykim dhe të aprovohet kërkesëpadija si e bazuar.

E paditura, me anë të përgjigjes në padi të dt.31.10.2024, ka theksuar se e konteston kërkesëpadinë e paditësit për kompensimin e pagës jubilarë, të paraparë sipas kontratës kolektive të arsimit para universitar, të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021, ngase Komuna e Podujevës nuk ka buxhet për të bërë këto pagesa. Tutje ka theksuar se në nenin 46 të kontratës kolektive të dt.18.04.2017, është paraparë se MASHT dhe SBASHK, angazhohen bashkërisht për t’i informuar dhe ndihmuar komunat që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe kostos financiare për pagesën e obligimeve që rrjedhin nga neni 35, andaj e paditura nuk ka buxhet për kryerjen e obligimeve ndaj punëtorëve. Po ashtu ka theksuar se kjo kontratë kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me kontratën kolektive. Tutje ka shtuar se paditësi fillimisht është dashur që këtë çështje ta iniciojë në procedurën administrative dhe me kërkesë ti drejtohet Drejtorisë së Arsimit por këtë paditësi nuk e ka bërë. Më tej ka theksuar se kemi parashkrim të kërkesës së paditësit ne kuptim të nenit 87 të Ligjit të Punës, ngase kane kaluar më tepër se tri vite nga arritja e jubileut të 30 – të. Tutje, i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit për kompensimin të pagës jubilarë ta refuzoj si të pa bazuar.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës të përcaktuara në nenin 399 të LPK-së, sepse nga përgjigja në padi rezulton qartas se kërkesëpadija e paditësit është e pathemeltë.

Gjykata vlerësoi pretendimet e palës së paditur të parashtruar përmes përgjigjes në padi, përkatësisht prapësimin e të paditurit lidhur me parashkrimin e kërkesës dhe gjeti se kërkesa e paditësit për kompensim shpërblimit jubilar është parashkruar.

Me dispozitën e nenit 87 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës është përcaktuar se: “*Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës*”. Andaj, bazuar në dispozitën e lartcekur, del se kërkesa paditëse për kompensim të pagave jubilarë parashkruhet për tre vite. Duke pasur parasysh se parashkrimi fillon të rrjedhë nga dita e parë pas ditës kur paditësi ka pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga i padituri, gjykata konstaton se në rastin konkret kemi parashkrim të kërkesës së lartcekur. Nga shkresat e lëndës del se afati për realizimin e të drejtës në shpërblimit jubilar ka kaluar para se të jetë ngritur padia dhe atë nga arritja e jubileut të 30 – të, e deri në ngritjen e padisë me datë 19.05.2023, kanë kaluar më tepër se tri vite prej ditës kur paditësja ka pasur të drejtë të kërkojë kompensimin në shpërblimin jubilar, respektivisht kanë kaluar më tepër se gjashtë vite nga arritje e jubileut të 30-të. Pra paditësja është dashur që padinë ta paraqes brenda tri viteve prej ditës së arritjes së jubileut të 30-të.

Andaj, duke pasur parasysh se në rastin konkret kërkesa e paditësit për shpërblim jubilar është parashkruar, gjykata mori aktgjykim me të cilën refuzoi kërkesëpadinë si të pa bazuar.

Pasi që gjykata e refuzoi kërkesëpadinë për shkak të parashkrimit, pretendimet e tjera të të paditurit të dhëna me përgjigje në padi gjykata i vlerësoi si jo relevante.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u mor konform dispozitës së nenit 450 dhe 452.1 të LPK-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në pajtim me dispozitat e cekura më lartë.

Gjykata Themelore në Prishtinë- Dega në Podujevë
Departamenti i Përgjithshëm
Divizioni Civil
C.nr.1048/2023, me dt.02.11.2024

Gjyqtari
Binak Duqi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj gjykate.